

SPECIFIKIMET TEKNIKE
PËR
SISTEMIN E MBROJTJES NDAJ ZJARRIT

Objekti :

**“MODIFIKIM DHE RIVLERËSIM TË PROJEKT , PREVENTVIT DHE TË ANALIZAVE TË
ÇMIMEVE ME OBJEKT: “ RIKONSTRUKSION I ZYRAVE TË PUNËSIMIT TË
DREJTORISË RAJONALE TIRANË, KATI I 3-të”**

Zhvillues:AKPA , DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Projektues: “Inday-18” Shpk

Tetor 2024

Pajisjet e MNZ

Furnizimi me ujë për shuarjen e zjarrit Në ndërtesë është e detyrueshme të sigurohet uji, i cili duhet të jetë në sasi dhe i përdorshëm për shuarjen e zjarreve eventuale, duke garantuar furnizimin në vazhdimësi me ujë të hidrantit, i cili duhet të jetë i instaluar. Për të patur sasinë e mjaftueshme të ujit sipas normës duke përfshirë këtu edhe rezervën e domosdoshme duhet instaluar një depozitë uji dhe një pompë për shtyrjen dhe shpërndarjen e ujit në drejtim të rrjetit të tubacioneve dhe sistemit shuarës.

Për këtë qëllim duhet të vendosen depozita me afro 5000 litra ujë, si dhe një pompë për hidrantin zjarrfikës. Tubacionet shpërndares të ujit duhet të jenë metalike dhe të mbrojtur nga korrozioni. Sistemi i furnizimit me ujë (pompa, depozita, tubacionet shpërndarës) dhe impianti i shuarjes, janë në përshtatje me nivelin e rrezikut për zjarr që kanë veprimtaritë që kryhen këtu (nivel normal) garantohen veprimet nga brenda dhe nga jashtë ndërtesës për shuarjen e zjarreve eventuale, gjithashtu sigurohet një autonomi veprimi në kohë më të gjatë se sa kërkon norma, për hidrantet zjarrfikës, afërsisht 2h.

Sistemet dhe pajisjet për diktim, sinjalizimin dhe shuarjen e zjarreve Sistemi i diktim - sinjalizimit të zjarreve Objektë duhet të ketë sistem diktim – sinjalizimi për rastet eventuale. Për këtë qëllim në tavanin e saj, duhet të instalohen sipas normës, koka detektuese (sensorë) të tipit të tymit. Këto detektorë veprojnë nën efektin e tymit dhe e kanë sipërfaqen e mbulimit 40 m² për çdo detektor. Sensorët e tymit mund të jenë central i tipit të adresuar ose të tipit me bateri. Për sigurinë e funksionimit të tyre, duhet të kontrollohen bateritë të paktën një herë në gjashtë muaj, si dhe detyrimisht bateritë të ndërrohen çdo dy vjet.

Hidrantet zjarrfikëse



Në objekt duhen instaluar hidrante zjarrfikëse. Hidrantet duhet të jenë të tipit DN 45, të kompletuar me tub zjarrfikës me gjatësi 20-25m, si dhe me hedhëse uji kompakte me diametër 45 mm. Hidrantet së bashku me kompletet e tyre duhet të jenë të futur në kaseta me ngjyrë të kuqe. Hidrantet duhet të instalohen në afërsi të derës hyrëse, në lartësi 125 cm, nga dyshemeja. Furnizimi me ujë i hidranteve bëhet nga depozita e ujit, rrjetit të tubacioneve dhe nëpërmjet pompës. Sasia dhe larghedhja e ujit nga secili hidrant, me kompletin që ato kanë në varësi të presionit, jepet në tabelë si më poshtë:

Diametri mm	Presioni bar	Prurja Lit/min	Larghedhja metra
12	3	165	11 deri 22
12	5	215	11 deri 25
12	8	270	12 deri 30

Është e domosdoshme të theksojmë:

- 1- Në asnjë rast nuk duhet lejuar që këto hidrante të përdoren përveç rasteve të zjarreve
- 2- Duhet bërë e ditur mirë se nuk lejohet përdorimi i hidranteve për shuarjen e zjarreve në instalimet dhe pajisjet elektrike. Përdorimi i ujit në këto raste është katastrofik për përdoruesin, pasi ai bie nën tension.

Duhen vendosur tabelat sinjalistike me mbishkrimin "Hidrant zjarri me ujë"



Fikëset e zjarrit

Objekti duhet paisur edhe me fikëse zjarri sipas normës. Në të gjithë objektin duhen vendosur fikëse zjarri të tipit me pluhur, me kapacitet mbajtes 6-9 kg. Fikset garantojnë fikjen e zjarreve në klasat A, B, C dhe E. Fikëset duhen vendosur në vende të dukshme dhe të jenë lehtësisht të përdorshme. Sipas normës duhet mbajtur parasysh që distance për të marre fikësin për përdorim, duhet të mos jetë më shumë se 20 m, nga vendndodhja e njerëzve. Numri dhe lloji i fikëseve është parashikuar në projektet respective, sipas kateve dhe është në përshtatje me kërkesat normative të mbrojtjes nga zjarri. Në pikat ku vendosen fikëset duhet të vendosen detyrimisht dhe tabelat sinjalistike "Fikëse zjarri me pluhur". Fikëset duhet të mbahen gjithmonë në

gatishmëri pune, të rimbushen pas çdo përdorimi dhe të kontrollohen në vazhdimësi. Është e detyrueshme që një herë në vit duhet të kontrollohen dhe të kolaudohen nga specialisti zjarrfikës ose nga firma të licensuara.

Klasat e zjarrit:

- A - trupa të ngurtë ose substanca që formojnë thëngjij
- B - substanca të lëngshme dhe substanca që shkrihen
- C - substanca të gazta
- D - metale të djegshme (janë shume të rrezikshme për shkak të prodhimit të nxehtësisë së lartë dhe duhet të shuhet vetëm nga skuadra e zjarrfikësve) Përdorimi i duhur i fikësve të ndryshëm të zjarrit

• Fikës zjarri portativ (fikës me pluhur të thatë ujë,shkumë dhe CO2)

- fikësit e zjarrit me pluhur të thatë për klasat A, B, C të zjarrit (me pluhur të veçantë për metalet e djegshme)
- fikësit e zjarrit me ujë për klasën A të zjarrit,
- fikësit e zjarrit me ujë për klasën A të zjarrit / instalimet elektrike me energji do të fiken me ujë vetëm në marrëveshje me personelin përgjegjës operativ. (ose hapësirë, ose distancë e përshtatshme sigurie)
- fikësit e zjarrit me shkumë për klasat A,B të zjarrit, fikësit e zjarrit me CO2 për klasat B, C të zjarrit për instalimet elektrike .

Bëni kujdes nëse fikësi përdoret në hapësira të ngushta dhe me ventilim të dobët (gaz i dëmshëm i shuarjes). Instalimet elektrike për tensione deri në 1000 V, duhet të ruhet një distancë sigurie prej të paktën 1m (mbi 1000 V, shuarja do të kryhet vetëm pas konsultimit me operatorët kompetentë)

- Paisjet e kontrollit

Kontraktori duhet të mbulojë, instalimin, testin, lidhejn dhe garanton një cilësi të lartë të veprimit të pajisjes sinjalizuese të zjarrit dhe sistemit të alarmit duke përfshirë dhe autoparlantët, ndriçuesit, pajisjet e alarmit, kontaktet e thyerjes së xhamit, panelët e alarmit të zjarrit, karikuesin e baterisë, dhe releve të shoqëruar, do sigurohen dhe lidhen në përputhje me specifikimet, sipas pozicioneve të treguara në vizatime. Instalimi do të kryhet me JY-(st)-Y 2x1 mm² kabëll për shuesit e zjarrit dhe NYMHY 2x1 mm, për autoparlant. Të gjithë sinjalizuesit do të pajisen me një shigjetë treguese të vendit të zjarrit. Sinjalizuesit kryesor do të sigurohen gjithashtu me lidhje ndërmjet terminaleve në mënyrë që të ndihmojë komandimin e njësive sinjalizuese në vizatimet e mëparshme.

Sinjalizuesit e tymit të duhanit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin. Çdo sinjalizues do të projektohet në mënyrë që të mbulojë një zonë prej 100 m². Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

- Zilet e alarmit

Autoparlantët e alarmit do të vendosen ndërmjet godinës. Vendondodhja do të caktohet për të siguruar:

- Minimumin e nivelit të tingullit prej 5db (A) është i pranishëm në çdo klasë.
- Mosfunksionimi i një zileje të mos ndikojë në nivelin e përgjithshëm të sinjalizimit.

Zilet e alarmit do të shkruhen me të kuq dhe do të shkruajnë qartë “Zjarr”.

Projektues

Shoqeria "Inday-18 " shpk

Administrator

Ing.Ana NAIPI